



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02. Nr. ____/2011
Dt: 03/08/2011

Duke u bazuar në Ligjin e shërbyesve Civil nr 03/L-149 neni 11, neni 18 paragrafi 1, Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010, si dhe pas miratimit dhe autorizimit për rekrutim nga Ministria e Administratës Publike nr. 404, Komuna Hani i Elezit Shpall këtë:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Koordinator të Qendrës së regjistrimit civil, në kuadër të Administratës komunale, Hani i Elezit

Kategoria dhe grada : (koeficienti 8.5)

Kohëzgjatja e kontratës: periudha provuese një vjeqare

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Është përgjegjës dhe kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore dhe procedurave për regjistrimin dhe lëshimin e dokumenteve civile
- Është përgjegjës për klasifikimin dhe ruajtjen e dokumenteve civile në QKRC
- Mban lidhje të ngushta me ZGJC- në mënyrë të kontrollimit dhe koordinimit të punëve
- Është përgjegjës për organizimin, mbykëqyrjen, udhëzimin dhe kontrollin e punës dhe stafit të QKRC- së
- Mban shënime të përditshme për të gjitha punët e kryera dhe raporton në baza javore, mujore, vjetore
- Kujdeset për pranimin e aplikacionit për regjistrimin civil dhe është përgjegjës për verifikimin e saktësisë, nëse aplikuesi ka afruar dokumentet e nevojshme për plotësimin e kriterëve të përcaktuara për tu regjistruar banor i Kosovës
- Kryen edhe punë të tjera sipas udhëzimeve të mbykëqyrësit

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim: Kandidatët për këtë vend pune duhet ti plotësojnë këto kushte:

- Të ketë pregaditje superiore (Diplomë Universitare)
- Të njohë punën me Kompjuter (Word, Excel, Acces,etj.)
- Preferohet të ketë përvojë punë
- Aftësi për të krijuar raporte të mira pune dhe ndërpersonale,
- Aftësi për të kuptuar shpejtë informacionin e ndërlikuar, në mënyrë të shpejtë të arrijë të hyjë në tema dhe çështje dhe të përcjell në mënyrë efektive informacionet e ndërlikuara,
- Referencë, mirënjohje apo çertifikatë të ndonjë institucioni apo organizate,
- Të posedoj patent shofer.

Kërkesat specifike:

- Dëshmi mbi kryerjen e obligimeve komunale

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve civil dhe rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010 e cila e rregullon rekrutimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Formularët e aplikimit mund të merren në zyrën e pritjes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 dhe do të dorëzohen po ashtu në zyrën e pritjes në objektin e Komunës kati i parë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes si dhe certifikata tjera mbi trajnimet e kryera.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

**Kryetari i Komunës
Rufki Suma**
